Lajmet

08/02/2024

Bulqizë/Goditet Një Tjetër Rast I Paligjshëm I Tregtimit Të Lëndëve Plasëse

Bulqizë/Goditet një tjetër rast i paligjshëm i tregtimit të lëndëve plasëse.

Magazinonte lëndë plasëse me qëllim për përdorim vetjak, por më pas e tregtonte (shiste) në 9 subjekte të tjera, Policia nis procedimin penal për pronarin e një subjekti minerar.

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Bulqizë, në përmbushje të objektivave të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e informalitetit, në bashkëpunim me Prokurorinë, bazuar në inteligjencën policore se një subjekt në mënyrë të paligjshme tregtonte (shiste), lëndë plasëse në disa subjekte të tjera minerare, kanë organizuar punën me qëllim verifikimin, parandalimin e mëtejshëm dhe goditjen e kësaj paligjshmërie.

Si rezultat, u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal, për veprën penale "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" për shtetasin G.Ç., 55 vjeç, banues në Tiranë.

Ky shtetas, në Thekën Martanesh, pasi magazinonte në depon e tij, sasi me lëndë plasëse me qëllim për përdorim vetiak, më pas në mënyrë të paligjshme dhe pa autorizim përkatës nga Komisariati i Policisë, e tregtonte (shiste) lëndën plasëse në 9 subjekte të tjera, duke u mjaftuar vetëm me një akt-marrveshje të lidhura mes palëve (subjekteve).

Në këtë subjekt janë sekuestruar 1416 kg lëndë plasëse dhe 220 kapsolla elektrike.

Kontrollet në subjektet minerare të qarkut, me qëllim verifikimin e zbatimit të ligjeve, kritereve dhe standardeve të sigurisë, vijojnë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

DVP Korçë/Procedohen në gjendje të lirë 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale

Bulqizë/Ndërhyrja në kohë e Policisë parandalon përshkallëzimin e mëtejshëm të një rasti dhune në familje

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2024 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.